



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

Nr. 290 Prot.

Tiranë, më 21, 09 2014

**Z. ELVIS ÇEFA**

**ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

**TIRANË**

I nderuar z. Çefa,

nga Ministri i Drejtësisë ju është kërkuar me shkresat nr.prot.239/11 datë 30.10.2012, nr. prot. 42 dhe nr. 43 datë 08.01.2013 procedimi disiplinor për gjyqtaret Valbona Duraj dhe Lindita Hoxha. Gjithashtu, për gjyqtarin Granit Qypi me shkresën nr. prot. 647/1 datë 27.3.2012 është kërkuar ndryshimi i vendimit nr. 260/3/a datë 01.04.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkak të konsumimit të afatit të delegimit dhe shkeljeve të konstatuara nga raporti i inspektimit tematik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Nga ana juaj jo vetëm që nuk janë marrë masat për tu shqyrtuar kërkesat në fjalë, por është lejuar si në rastin e gjyqtarit Granit Qypi, vazhdimi në kundërshtim me ligjin në funksionin e tij si drejtues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, pavarësisht kërkesës së Ministrit të Drejtësisë.

Po kështu, në rastin e gjyqtarës Valbona Duraj në kundërshtim me ligjin është lejuar promovimi i saj pavarësisht kërkesës së sipërpërmendur të Ministrit të Drejtësisë. Me dekretin nr. 8268, datë 16.7.2013, znj.Duraj është emëruar gjyqtare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe më pas me vendimin nr.368 datë 28.10.2013 është deleguar si kryetare e kësaj gjykate.

Ndonëse ka kaluar mbi 1 vit nga depozitimi i këtyre kërkesave, Këshilli i Lartë i Drejtësisë në mungesë të plotë të eficensës jo vetëm që nuk i ka shqyrtuar propozimet në fjalë por në të kundërt ka lejuar promovimin e këtyre gjyqtarëve.

Në zbatim të nenit 22 të Ligjit nr. 8811 datë 17.5.2001 “ Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, kërkoj nga ana juaj që propozimet e sipërcituara të përfshihen në rendin e ditës së mbledhjes më të afërt.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**MINISTRI**

**NASIP NAÇO**